FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.79 28 korrik 2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9573 datë 3.7.2006	Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to……	2271
Ligj nr.9574 datë 3.7.2006	Për disa ndryshime në ligjin nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar…….	2282
Ligj nr.9575 datë 3.7.2006	Për faljen e gjobave të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për personat juridikë e fizikë, të regjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël, për periudhat tatimore të vitit 2005……	2283
Ligj nr.9576 datë 3.7.2006	Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar……	2284
Vendim i Kuvendit nr.48, datë 13.7.2006	Për zëvendësimin e dy anëtarëve në Këshillin e Lartë të Drejtësisë……	2288
Vendim i Kuvendit nr.49, datë 13.7.2006	Për lirimin dhe emërimin e një anëtari të grupit mbikëqyrës të kontrollit financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i	2288

	gjerë……	
Vendim i Kuvendit nr.50, datë 13.7.2006	Për emërimin e një anëtari të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës…… ……...	2289
Vendim i Kuvendit nr.52, datë 17.7.2006	Për emërimin e Kryetarit të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës…… ……	2289
Dekret nr.4982 datë 19.7.2006	Për lirim ambasadori……	2289
Dekret nr.4983 datë 19.7.2006	Për emërim ambasadori……	2290
Vendim i KM nr.486, datë 14.7.2006	Për caktimin e datës së krijimit të Shërbimit Sekret të Shtetit Shqiptar…… …….	2290
Vendim i KM nr.488, datë 14.7.2006	Për veprimtarinë financiare të Qendrës së Publiklimeve Zyrtare…… ……	2291
Vendim i KM nr.507, datë 19.7.2006	Për një ndryshim në vendimin nr.590, datë 22.12.1997 të Këshillit të Ministrave "Për caktimin e anëtarëve në këshillin administrativ të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor", të ndryshuar……...	2291
Vendim i KM nr.509, datë 19.7.2006	Për përbërjen e këshillit drejtues të Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve dhe për mënyrën e masën e shpërblimit të anëtarëve të tij……	2292
Vendim i ERE nr.39, datë 14.7.2006	Për mosfillimin e procedurave të shqyrtimit…….	2292
Vendim i ERE nr.40, datë 14.7.2006	Për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për periudhën 1.1.2005 deri më 31.12.2005 për shoqërinë "Juana" sh.p.k……	2293
Vendim i ERE nr.41, datë 14.7.2006	Për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për periudhën 1.10.2005 deri më 31.12.2006 për shoqërinë "Marjakaj" sh.p.k……	2293
Vendim i ERE nr.42, datë 14.7.2006	Për mosfillimin e procedurave të shqyrtimit për aplikimin për ndërtimin dhe instalimin e një H/C të ri nga shoqëria "Remi" sh.p.k…… …...	2294

Vendim i ERE nr.43, datë 14.7.2006	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit……	2294
Vendim i ERE nr.44, datë 21.7.2006	Për mospranimin e aplikimit të shoqërisë GSA sh.p.k. për aktivitetin e eksportit të energjisë elektrike……	2295
Vendim i KKRT nr.483, datë 17.7.2006	Mbi licencën e subjektit televiziv vendor “TV Përmeti”……	2295
Vendim i KKRT nr.484, datë 17.7.2006	Për dhënie licence për televizionin vendor privat “Durrësi” ..	2297
Vendim i KKRT nr.485, datë 17.7.2006	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “Mirdita”...	2297
Vendim i KKRT nr.486, datë 17.7.2006	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “Erzeni”….	2298
Vendim i KKRT nr.487, datë 17.7.2006	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “Synej”……	2298
Vendim i KKRT nr.488, datë 17.7.2006	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “Top Channel”……	2299
Vendim i KKRT nr.489, datë 17.7.2006	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “Tele-Sport”……	2299
Vendim i KKRT nr.490, datë 17.7.2006	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV Koha”…….	2300
Vendim i KKRT nr.491, datë 17.7.2006	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV Vizion +”……...	2300
Vendim i KKRT nr.492, datë 17.7.2006	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik vendor “House of Arts”…….	2301
Vendim i KKRT nr.493, datë 17.7.2006	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik vendor “Euro Star Music”……	2301
Vendim i KKRT nr.494, datë 17.7.2006	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik vendor “Radio +3”……	2302
Vendim i KKRT nr.495, datë 17.7.2006	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik me përsëritës “Radio BBC”……	2302
	Shpallje kërkese për shpronësim publik me objekt “Ndërtimin e projektit të ujësjellës-kanalizime Fushë-Krujë”……	2303

L I G J
Nr.9573, datë 3.7.2006

PËR AUTORIPARIMIN, SHITBLERJEN, DEPOZITIMIN E MJETEVE RRUGORE ME MOTOR, TË RIMORKIOVE DHE PJESËVE TË TYRE TË DALA JASHTË PËRDORIMIT OSE TË BRAKTISURA DHE PËR VEPRIMTARITË QË LIDHEN ME TO

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ligji ka si qëllim të rrisë në një shkallë më të lartë sigurinë në qarkullimin rrugor, si dhe të parandalojë e të luftojë trafikun e mjeteve të vjedhura. Gjithashtu, përcakton rregullat që duhen zbatuar për kryerjen e shërbimeve nga subjektet që kryejnë veprimtarinë e autoriparimit, që blejnë, shesin apo ndërmjetësojnë në shitblerje, që pjesëzojnë, rivënë në punë, japin mjete me qira ose vënë në dispozicion të të tretëve mjetet e tyre, që depozitojnë dhe shkatërrojnë mjetet e dala jashtë përdorimit, si dhe përcakton rregullat për ushtrimin e veprimtarisë së agjencive, që trajtojnë praktikat për qarkullimin e mjeteve me motor dhe të rimorkiove.

Neni 2
Objekti i ligjit

Ky ligj disiplinon dhe monitoron veprimtaritë për autoriparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve motorike, blerjen dhe shitjen e tyre, vendruajtjet, dhënien me qira, si dhe mbledhjen, depozitimin dhe shkatërrimin e mjeteve ose të pjesëve të tyre, të dala jashtë përdorimit ose të braktisura.

KREU II
DHËNIA E LEJEVE PËR VEPRIMTARINË E AUTORIPARIMIT

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. “Autoriparim” është riparimi dhe mirëmbajtja e mjeteve me motor dhe e rimorkiove, të destinuara për transportin rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave, me përjashtim të shërbimeve të larjes, të fryrjes së gomave, të furnizimit me karburant, zëvendësimit të filtrit të ajrit dhe të vajit, të lëndës djegëse dhe të lubrifikantëve, të lëngjeve punuese hidraulike dhe të lëngjeve ftohëse.

2.“Veprimtari të riparimit” janë të gjitha operacionet për zëvendësimin dhe modifikimin e çdo komponenti të mjeteve me motor dhe rimorkiove, si dhe instalimin e impianteve e të komponenteve fikse në një mjet të vetëm ose në një kompleks mjetesh me motor.

3. “Veprimtari e mirëmbajtjes së mjeteve me motor dhe të rimorkiove” është mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të karrocerisë, të impiantit elektrik dhe të gomave.

Neni 4
Regjistrimi i subjekteve që ushtrojnë veprimtari autoriparimi

1. Ushtrimi i veprimtarisë së autoriparimit, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj, u lejohet vetëm subjekteve, që respektojnë legjislacionin në fuqi për qarkullimin rrugor dhe për normat e kujdesit ndaj mjedisit, ndaj ndotjeve dhe parandalimit të dëmtimeve dhe që janë të regjistruara sipas këtij ligji.

2. Regjistrimi i subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari autoriparimi bëhet pranë drejtorive rajonale të shërbimeve të transportit rrugor, ku subjekti ka selinë, në regjistrin e hapur për këtë qëllim.

3. Regjistri ndahet në 6 seksione:

a) për veprimtaritë e riparimit dhe të mirëmbajtjes së pjesëve mekanike dhe të motorit;

b) për riparimin dhe mirëmbajtjen e karrocerisë;

c) për riparimin dhe mirëmbajtjen e impiantit elektrik;

ç) për riparimin dhe mirëmbajtjen e gomave;

d) për subjektet që blejnë, shesin mjete me motor dhe rimorkio;

dh) për subjektet që mbledhin, depozitojnë, shkatërrojnë mjetet ose pjesë të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura.

4. Subjektet, për fillimin e veprimtarisë regjistrohen në regjistër dhe më pas pajisen nga drejtoria rajonale e shërbimeve të transportit rrugor me vërtetimin përkatës, ku përcaktohet edhe lloji i veprimtarisë që do të ushtrohet.

5. Çdo subjekt mund të regjistrohet në një ose më shumë seksione të regjistrit, në përputhje me veprimtaritë që do të ushtrojë.

6. Subjektit nuk i lejohet të kryejë autoriparime të tjera nga ato të përcaktuara në regjistër, për të cilat është pajisur me leje.

Neni 5

Mënyra e plotësimit të regjistrit

1. Pajisjet, instrumentet, mjediset e nevojshme, të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë së autoriparimit sipas seksioneve, përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon fushën e transportit.

2. Ministri që mbulon fushën e transportit përcakton me udhëzim modelin e regjistrit, të parashikuar në pikat 2 e 3 të nenit 4 të këtij ligji, si dhe mënyrën e plotësimit të tij.

Neni 6

Kushtet dhe procedurat për regjistrim

1. Ministri që mbulon fushën e transportit përcakton, me udhëzim, kushtet dhe procedurat, që duhet të plotësojnë subjektet për t'u regjistruar.

2. Subjektet, që kërkojnë të regjistrohen në regjistër, duhet të kenë detyrimisht një përgjegjës teknik, i cili duhet të jetë inxhinier mekanik ose teknik, mekanik transporti. Përgjegjësi teknik mund të jetë edhe drejtuesi ekzekutiv i subjektit.

Neni 7

Veprimtaria e autoriparimit nga subjektet që tregtojnë mjete me motor e rimorkio dhe/ose ushtrojnë veprimtari transporti

1. Veprimtaria e autoriparimit, e realizuar me instrumente ose pajisje ndihmëse, u lejohet edhe subjekteve, që ushtrojnë veprimtari për tregtimin e mjeteve rrugore me motor dhe të rimorkiove, si dhe subjekteve që kryejnë transport mallrash për llogari të të tretëve.

2. Subjektet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, që të ushtrojnë veprimtarinë e autoriparimit, shënohen në njërën ose në disa nga seksionet e përmendura në pikën 3 të nenit 4 të këtij ligji, sipas veprimtarisë që do të ushtrojnë, pasi të kenë plotësuar kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të nenit 6 të këtij ligji.

Neni 8

Detyrimet e pronarit ose të përdoruesit të mjeteve me motor dhe/ose rimorkiove

1. Pronarët ose përdoruesit e mjeteve me motor dhe/ose rimorkiove, për mirëmbajtjen dhe riparimin e këtyre mjeteve, u drejtohen vetëm subjekteve të regjistruara në regjistër, sipas llojit të përcaktuar në lejen përkatëse.

2. Përjashtohen nga detyrimi i pikës 1 të këtij neni pronarët ose përdoruesit e mjeteve me motor dhe/ose rimorkiove për veprimtaritë e shërbimeve të larjes, të fryrjes së gomave, të furnizimit me karburant, zëvendësimit të filtrit të ajrit dhe të vajit, të lëndës djegëse dhe të lubrifikantëve, të lëngjeve punuese hidraulike dhe të lëngjeve ftohëse.

Neni 9
Përgjegjësi teknik

1. Përgjegjësi teknik, i përcaktuar në pikën 2 të nenit 6 të këtij ligji, duhet të plotësojë këto kërkesa:

a) të mos jetë dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për vepra penale të kryera në ushtrimin e veprimtarive të përmendura në pikën 2 të nenit 3 të këtij ligji;

b) të ketë aftësi fizike për të kryer këtë veprimtari, të vërtetuar nga organi shëndetësor përkatës, brenda juridiksionit ku banon.

2. Përgjegjësi teknik pajiset me "Dëshmi aftësie profesionale" nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, pasi të ketë kaluar provimin për nivelin e njohurive, të cilat përcaktohen në udhëzimin e ministrit që mbulon fushën e transportit.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor organizon kurse kualifikimi me programe të miratuara nga ministria që mbulon fushën e transportit, për ngritjen e nivelit tekniko-profesional të përgjegjësve teknikë dhe të punonjësve të tjerë të subjekteve, që ushtrojnë veprimtari autoriparimi.

Neni 10
Përgjegjësitë e subjekteve që ushtrojnë veprimtari autoriparimi

1. Subjektet e ushtrojnë veprimtarinë e autoriparimit në përputhje me këtë ligj dhe mbajnë përgjegjësi për operacionet e kryera, sipas dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë (Kontrata e porosisë, kontrata e shitblerjes dhe ajo e qirasë).

2. Ministri që mbulon fushën e transportit përcakton vlerën e garancisë detyruese, që subjektet duhet të ngurtësojnë para marrjes së lejes për ushtrimin e veprimtarisë së autoriparimit.

Neni 11
Regjistri i mjeteve në riparim

1. Subjektet, që ushtrojnë veprimtari autoriparimi, të parashikuar në nenin 3 të këtij ligji, duhet të mbajnë një regjistër, ku të shënojnë në mënyrë të saktë e kronologjike, pa korrigjime:

a) targën dhe numrin e shasisë së mjetit, ku do të bëhen ndërhyrjet;

b) të dhënat për ndërhyrjet e realizuara;

c) datën e marrjes dhe të dorëzimit të mjetit pronarit të ligjshëm ose personit të autorizuar prej tij;

ç) gjenealitetet e personit, që dorëzon mjetin dhe të personit, të cilit i dorëzohet mjeti.

2. Mbajtja e të dhënave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni bëhet në çastin e marrjes dhe të dorëzimit të mjetit.

KREU III
SHITBLERJA E MJETEVE

Neni 12
Veprimtaria e shitblerjes së mjeteve të reja ose të përdorura

1. Veprimtaria e shitblerjes së mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove, të reja ose të përdorura, u lejohet vetëm subjekteve juridike, të regjistruara në seksionin përkatës të regjistrit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

2. Blerësi ose personi që zotëron mjete rrugore me motor dhe/ose rimorkio të përdorura, nuk mund t' i përshtasë ato pa kaluar 20 ditë nga data e regjistrimit të blerjes së tyre në regjistër, në përputhje me nenin 11 të këtij ligji.

Neni 13
Regjistri i shitblerjeve

l. Subjekti, që ushtron veprimtarinë e parashikuar në nenin 12 të këtij ligji, duhet të mbajë një regjistër, ku të shënojë, në mënyrë të saktë e kronologjike, pa korrigjime:

a) targën e mjetit, nëse e ka, dhe numrin e shasisë që, me çfarëdo titulli, e mban në lokal apo depozitë ose në afërsi të tyre;

b) datën e marrjes në dorëzim të mjetit;

c) treguesit e origjinës së mjetit, nëse ka targë, si dhe të dhënat e dokumenteve të qarkullimit e të datës së regjistrimit;

ç) gjenealitetet e personave, që i sjellin ose i transportojnë mjetet;

d) datën e shitjes ose të heqjes së mjetit, me çfarëdo titulli;

dh) gjenealitetet e blerësit ose të personit, të cilit i është dorëzuar mjeti.

2. Të dhënat për origjinën e mjeteve rrugore me motor dhe/ose rimorkiove shënohen në çastin e marrjes në ngarkim të tyre ose në çastin e vendosjes në mjediset që zotërojnë.

3. Të dhënat për shitjen ose heqjen, për çdo arsye, të mjeteve rrugore me motor dhe/ose rimorkiove shënohen në çastin e shitjes ose të heqjes së tyre.

KREU IV
NDËRMJETËSIMI NË SHITBLERJE

Neni 14
Veprimtaria e ndërmjetësimit

1. Subjektet, që ushtrojnë veprimtarinë e ndërmjetësimit, kundrejt pagesës, në shitblerjen e mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove, të reja ose të përdorura, trajtohen si subjekte të tatueshme dhe i nënshtrohen legjislacionit në fuqi.

2. Personat, që kryejnë veprime me subjektet e mësipërme, janë të detyruar të identifikohen, nëpërmjet letërnjoftimit ose një dokumenti tjetër, me të njëjtën vlerë, të pajisur me fotografi, të lëshuar nga institucionet shtetërore.

3. Subjektet e lartpërmendura duhet të mbajnë në mjediset ku ushtrojnë veprimtarinë, në vende të dukshme, tabelat e veprimeve që kryejnë, si dhe tarifat përkatëse për çdo ndërhyrje të bërë. Në të kundërt u nënshtrohen sanksioneve, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Kryerja e veprimeve të ndryshme nga ato të shënuara në tabelat përkatëse, si dhe marrja e vlerave më të mëdha nga ato të treguara në këto tabela, përbëjnë shkelje dhe dënohen sipas këtij ligji.

Neni 15
Regjistri ditor i veprimtarisë

Subjektet, që ushtrojnë veprimtarinë e parashikuar në nenin 14 të këtij ligji, janë të detyruara të mbajnë një regjistër, ku të shënojnë veprimet që kryejnë çdo ditë, në mënyrë të saktë dhe kronologjike, pa korrigjime, gjenealitetet e personave, me të cilët kanë kryer një ndërmjetësim, si dhe të dhëna të tjera, që kanë të bëjnë me ndërmjetësimin.

KREU V
MBLEDHJA, DEPOZITIMI, SHKATËRRIMI I MJETEVE RRUGORE ME MOTOR, I RIMORKIOVE DHE I PJESËVE TË TYRE TË DALA JASHTË PËRDORIMIT OSE TË BRAKTISURA

Neni 16
Regjistrimi i subjekteve dhe ushtrimi i veprimtarisë së mbledhjes, depozitimit, pjesëzimit dhe copëtimit të mjeteve

1. Mjetet rrugore me motor dhe rimorkiot, të nxjerra jashtë përdorimit, vendosen në vende të veçanta, të përcaktuara në bashkëpunim me organet përkatëse të pushtetit vendor, sipas kërkesave për mbrojtjen e mjedisit.

2. Subjektet lejohen të fillojnë veprimtarinë e mbledhjes, të depozitimit, pjesëzimit dhe copëtimit të mjeteve, pasi të jenë regjistruar pranë drejtorisë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor, në territorin ku kanë selinë, kundrejt autorizimit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë.

3. Drejtoritë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor bëjnë regjistrimin e subjekteve, sipas udhëzimit të ministrit që mbulon fushën e transportit.

Neni 17

Regjistri i hyrje-daljeve

1. Subjektet, që kryejnë veprimtaritë e parashikuara në nenin 16 të këtij ligji, janë të detyruara të mbajnë një regjistër të veçantë për të gjitha hyrje-daljet, ku të shënojnë, në mënyrë të saktë dhe kronologjike, pa korrigjime:

a) targën, numrin e shasisë së mjetit dhe gjenealitetet e pronarit ose të personit që e ka dorëzuar apo transportuar;

b) të dhënat për karakteristikat cilësore dhe sasiore të elementeve që mund të rishfrytëzohen;

c) treguesit e pjesëve ose të elementeve të rishfrytëzueshme, që janë shitur, me çfarëdo titulli apo janë hedhur, si dhe gjenealitetet e personit, të cilit i janë shitur;

ç) treguesit sasiorë e cilësorë të elementeve të papërdorshme, të dërguara për riciklim;

d) metodën e trajtimit.

2. Regjistri mbahet në mjediset ku kryhen grumbullimi, çmontimi, depozitimi ose copëtimi i mjeteve apo i pjesëve të tyre.

3. Ministri që mbulon fushën e transportit përcakton me udhëzim modelin e regjistrit, të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, si dhe mënyrën e plotësimit dhe të mbajtjes së tij.

KREU VI

SHITBLERJA E PJESËVE TË KËMBIMIT TË MJETEVE RRUGORE ME MOTOR DHE/OSE TË RIMORKIOVE

Neni 18

Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove

1. Subjektet, përpara se të fillojnë veprimtarinë e tregtimit të pjesëve të këmbimit të mjeteve, janë të detyruara të regjistrohen pranë drejtorisë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor, në territorin ku kanë selinë.

2. Drejtoritë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor bëjnë regjistrimin e subjekteve, sipas udhëzimit të ministrit që mbulon fushën e transportit.

3. Subjektet tregtuese, fabrikuese dhe përfaqësuesit e tyre të huaj, që kërkojnë të tregtojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë pjesë këmbimi të mjeteve të importuara nga ata vetë, janë të detyruar të regjistrohen pranë drejtorisë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor, në territorin ku kanë selinë.

4. Regjistrimin e përmendur në pikën 1 të këtij neni janë të detyruar ta bëjnë edhe agjentët, komisionerët udhëtues dhe shitësit ambulantë të subjekteve, të parashikuara në pikën 3 të këtij neni.

Subjektet e sipërpërmendura duhet ta vërtetojnë cilësinë e përfaqësimit nëpërmjet një certifikate të lëshuar nga zyra përkatëse e shtetit, ku ka qendrën subjekti dhe të legalizuar nga autoritetet konsullore të atij vendi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 19

Regjistri i shitblerjeve të pjesëve të këmbimit

1. Fabrikuesit, tregtarët, përfaqësuesit e tyre të huaj dhe personat e parashikuar në nenin 18 të këtij ligji duhet të mbajnë një regjistër, ku të shënojnë kronologjikisht, krahas datës së marrjes në ngarkim të pjesëve të këmbimit, të elementeve dhe origjinën e tyre, edhe:

a) datën e shitjes ose të dorëzimit, me çfarëdo titulli, të këtyre pjesëve dhe elementeve;

b) gjenealitetet e personave, me të cilët kanë kryer veprime tregtare.

2. Personat, që kryejnë veprime tregtare me këto subjekte, janë të detyruar të vërtetojnë identitetin, siç është përcaktuar në pikën 2 të nenit 14 të këtij ligji.

KREU VII
VEPRIMTARIA E AGJENCIVE PËR PRAKTIKAT E QARKULLIMIT TË MJETEVE ME MOTOR DHE/OSE RIMORKIOVE

Neni 20
Ushtrimi i veprimtarisë së trajtimit të praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor

Në kuptim të këtij ligji, me veprimtari të trajtimit të praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove kuptohet kryerja, kundrejt pagesës, e këshillimit, asistencës, përshpejtimit të procedurave dhe plotësimit të dokumentacionit të kërkuar nga agjencitë, për llogari të çdo personi ose subjekti që kërkon të kryejë veprimtaritë, që rregullohen me këtë ligj ose që lidhen me qarkullimin rrugor të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove.

Neni 21
Leja për ushtrimin e veprimtarisë së një agjencie

1. Veprimtaritë e parashikuara në nenin 20 të këtij ligji kryhen nga subjekte të licencuara nga ministri që mbulon fushën e transportit.

2. Kriteret e licencimit dhe numri i agjencive, për çdo qytet, përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon fushën e transportit, duke pasur parasysh numrin e mjeteve me motor të regjistruara.

Neni 22
Dhënia e lejes agjencive

Leja për ushtrimin e veprimtarisë së agjencisë, parashikuar në nenin 21 të këtij ligji, lëshohet në emër të subjektit, titullari i të cilit duhet të ketë aftësitë profesionale, sipas neneve 23 e 29 të këtij ligji.

Neni 23
Vërtetimi i aftësisë profesionale për ushtrimin e veprimtarisë së agjencisë

1. Vërtetimi i aftësisë profesionale për ushtrimin e veprimtarisë së agjencisë lëshohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, pasi titullari ka marrë provimin e aftësisë nga komisioni i ngritur me urdhër të ministrit që mbulon fushën e transportit, me punonjës të drejtorive që mbulojnë këtë veprimtari në ministri dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

2. Sesionet e provimeve janë vjetore dhe kryhen në çdo qark, sipas mënyrave dhe programeve të hartuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe të miratuara nga ministri që mbulon fushën e transportit.

3. Provimi bëhet me shkrim, bazuar në pyetësorë me disa përgjigje alternative, për njohjen e legjislacionit të përgjithshëm dhe të veçantë, për qarkullimin rrugor, për transportin e udhëtarëve e të mallrave dhe për sistemin e taksave për këtë sektor. Çështjet, mbi të cilat përgatiten pyetësorët, u vihen në dispozicion të interesuarve të paktën 60 ditë para datës së provimit.

4. Provimit të aftësisë nuk u nënshtrohen personat, që kanë qenë nëpunës të sektorëve të ministrisë që mbulon veprimtarinë, të sektorëve që mbulojnë veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe të sektorëve që mbulojnë veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Rrugore dhe që kanë qenë në këtë detyrë të paktën 3 vjet pa ndërprerje, nga data e hyrjes në fuqi të Kodit Rrugor.

Neni 24
Regjistri ditor i veprimtarisë

Titullari i subjektit (agjencisë) duhet të mbajë një regjistër ditor, ku të shënohen, në mënyrë të saktë dhe kronologjike, pa korrigjime:

a) të dhënat identifikuese të klientit kërkues dhe të mjetit të transportit;

b) data dhe natyra e shërbimit të kërkuar;
c) veprimet, të cilave u referohet shërbimi i kërkuar.

Neni 25
Tarifat e shërbimit

Tarifat për çdo shërbim përcaktohen nga agjencitë dhe afishohen në tabelat përkatëse, në mjediset ku agjencia kryen veprimtarinë. Në të kundërt, agjencia u nënshtrohet sanksioneve, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU VIII
VEPRIMTARIA E VËNIES NË DISPOZICION DHE E DHËNIES ME QIRA TË MJETEVE RRUGORE ME MOTOR PA DREJTUES MJETI

Neni 26
Ruajtja e mjeteve në mjedise private e publike

1. Ruajtja e mjeteve në mjedise private e publike bëhet vetëm me lejen e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe sigurinë.
2. Në leje përshkruhen mjediset, ku do të vendosen mjetet, numri i tyre maksimal, sistemet e mbrojtjes nga zjarri, daljet e sigurisë dhe çdo element tjetër i nevojshëm për ruajtjen e sigurisë publike.
3. Ministri që mbulon rendin përcakton, me udhëzim, kriteret që duhet të plotësojnë subjektet fizike dhe juridike, për t'u pajisur me leje për ruajtjen e mjeteve në mjedise private e publike.

Neni 27
Vënia në dispozicion e mjeteve pa drejtues

1. Për ushtrimin e veprimtarisë së dhënies me qira të mjeteve pa drejtues, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë lëshon leje, sipas udhëzimit të ministrit që mbulon rendin.
2. Leja jepet nëse subjektet fizike dhe/ose juridike plotësojnë normat në fuqi në fushën e tregtimit, të mbrojtjes nga zjarri dhe të sigurisë.

Neni 28
Regjistri i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të depozituara ose të dhëna me qira

1. Ushtruesit e veprimtarisë, sipas neneve 26 e 27 të këtij ligji, duhet të mbajnë një regjistër, ku të shënojnë, në mënyrë të saktë dhe kronologjike, pa korrigjime:
a) datën e marrjes në dorëzim të mjetit dhe datën e ridorëzimit të tij;
b) gjenealitetet e personit, të cilit i dorëzohet mjeti, si dhe të personit që e dorëzon.
2. Të dhënat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni shënohen në çastin e marrjes në dorëzim ose të ridorëzimit të mjetit.

KREU IX
DISPOZITAT PËR LËSHIMIN E LEJEVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË DHE MBAJTJA E REGJISTRAVE

Neni 29
Kompetencat për lëshimin e lejeve

1. Lejet për ushtrimin e veprimtarisë së shitblerjes, të ndërmjetësimit, të autoriparimit për mjetet rrugore me motor dhe rimorkiot, të autorizuara nga prodhuesi i tyre, për subjektet juridike që ushtrojnë këto veprimtari dhe për agjencitë që trajtojnë praktikat e qarkullimit rrugor, lëshohen nga ministri që mbulon fushën e transportit.
2. Lejet për subjektet juridike ose fizike, që ushtrojnë veprimtarinë e ruajtjes së mjeteve në mjedise private ose publike, të vënies në dispozicion dhe të qiradhënies së mjeteve rrugore me motor dhe të

rimorkiove pa drejtues mjeti, lëshohen nga drejtoria rajonale e policisë së qarkut.

3. Lejet për subjektet juridike ose fizike, që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në këtë ligj, por të ndryshme nga ato të pikave 1 e 2 të këtij neni, lëshohen nga DPSHTRR-ja.

4. Tarifat e dhënies së lejeve të përcaktuara në pikat 1, 2 e 3 të këtij neni miratohen nga Ministria e Financave.

Neni 30

Kërkesat për marrjen e lejeve

1. Lejet nuk u jepen personave:

a) të dënuar, me vendim gjykate të formës së prerë, për krime kundër rendit publik dhe/ose kundër personit, të kryera me dhunë, vjedhje, rrëmbim personi, me qëllim përfitimi, dhunë e rezistencë ndaj autoriteteve, ose që kanë kryer dënim me heqje lirie më shumë se tre vjet, për krime për motive të dobëta.

b) që nuk zotërojnë mjedise të përshtatshme pune dhe mundësi të mjaftueshme financiare, të vlerësuara sipas kritereve të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët të ministrit që mbulon fushën e transportit dhe të ministrit që mbulon rendin, të dalë brenda 60 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

2. Për shoqëritë tregtare, leja lëshohet në emër të shoqërisë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

3. Për shoqëritë, kërkesat e veçanta të formimit ose të aftësisë profesionale duhet të plotësohen, të paktën, nga njëri prej ortakëve.

Neni 31

Përgjegjësia profesionale

Titullari i subjekteve juridike është përgjegjës për ushtrimin e veprimtarisë, për të cilën është marrë leja, duke mbartur të drejtat dhe detyrimet, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

Neni 32

Kushtet e lejeve

Përveç kushteve të vendosura në këtë ligj, subjekti i pajisur me leje duhet të respektojë edhe kushtet e vendosura për interesa publikë, nga autoritetet e Policisë së Shtetit.

Neni 33

Vlefshmëria dhe revokimi i lejeve

l. Lejet e parashikuara në këtë ligj hyjnë në fuqi një ditë pas lëshimit të tyre dhe kanë vlefshmëri deri në 5 vjet, me të drejtë rinovimi.

2. Lejet revokohen kur:

a) dëmtojnë interesat e palëve, të cilave u drejtohen;

b) të gjitha palët e interesuara bien dakord për revokimin ose shfuqizimin e saj, me kusht që leja të ketë krijuar të drejta të tilla, nga të cilat nuk mund të hiqet dorë.

3. Lejet e parashikuara në këtë ligj mund të revokohen ose të pezullohen në çdo rast nga organi që i ka lëshuar ato, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe.

4. Në rast abuzimi nga personi i pajisur me leje, lejet me delegim mund të revokohen nga organi delegues ose nga organi i deleguar për aq kohë sa delegimi është i vlefshëm.

Neni 34

Përfaqësimi në ushtrimin e veprimtarive të regjistruara

1. Lejet e parashikuara në këtë ligj janë për subjektet e regjistruara dhe nuk mund t'u jepen ose t'u transferohen, me çfarëdo titulli, subjekteve të tjera.

2. Për ushtrimin e veprimtarisë, sipas këtij ligji, është i nevojshëm përfaqësimi. Përfaqësuesi duhet të ketë dokument ligjor përfaqësimi nga subjekti.

3. Gjenealitetet e përfaqësuesit shënohen në titullin e lejes.

KREU X
DISPOZITA PËR MBAJTJEN E REGJISTRAVE

Neni 35
Mbajtja e regjistrave

1. Regjistrat e parashikuar në këtë ligj duhet të jenë të numërtuara, të vulosura në çdo faqe nga organet që lëshojnë lejet dhe të kompjuterizuara.

2. Këta regjistra duhet të mbahen në gjendje të mirë dhe shënimet duhet të bëhen në mënyrë kronologjike, pa fshirje, korrigjime ose heqje.

3. Me përfundimin e veprimtarisë, për të cilën është lëshuar leja përkatëse, regjistrat i kthehen autoritetit që ka lëshuar lejen.

4. Modeli i regjistrave dhe i dokumenteve zëvendësuese, si dhe mënyrat e plotësimit dhe kompjuterizimit të tyre përcaktohen në udhëzimet e përbashkëta të ministrit që mbulon transportin dhe të ministrit që mbulon rendin publik.

5. Regjistrat u vihen në dispozicion autoriteteve të caktuara për kontroll, si dhe autoriteteve të tjera që, për motive të ndryshme, duhet të kontrollojnë shënimet e bëra në regjistra.

Neni 36
Paraqitja e dokumentit të identifikimit

1. Në të gjitha veprimet, për të cilat, sipas këtij ligji, kërkohet identifikimi i personit, është e nevojshme paraqitja e letërnjoftimit ose e një dokumenti tjetër identifikues, me fotografi, të lëshuar nga organet përkatëse shtetërore.

2. Në të gjitha rastet, të dhënat për gjenealitetet e personave, sipas pikës 1 të këtij neni, shënohen në regjistër, së bashku me numrin e letërnjoftimit ose të dokumentit tjetër identifikues.

KREU XI
SANKSIONET DHE USHTRIMI I KONTROLLIT

Neni 37
Mbikëqyrja dhe kontrolli

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për kontrollin dhe zbatimin e këtij ligji, si dhe për vendosjen e mbledhjen e gjobave për kundërvajtjet administrative.

Neni 38
Kontrollet e DPSHTRR-së dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit

1. Punonjësit e autorizuar të DPSHTRR-së dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit lejohen të hyjnë në mjediset, ku ushtrohen veprimtaritë e parashikuara në lejet përkatëse, për të verifikuar përmbushjen e kushteve teknike.

2. Punonjësit e autorizuar të DPSHTRR-së dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit mund të kontrollojnë, në çdo rast, lejet dhe regjistrat e subjekteve, që ushtrojnë veprimtari sipas këtij ligji.

Neni 39
Ushtrimi i veprimtarisë pa leje

1. Ushtrimi pa leje i çdo veprimtarie, për të cilat ky ligj kërkon marrjen e lejes, si dhe shënimi i të dhënave fiktive në regjistër përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë :

a) për subjektet, me objekt veprimtarie sipas nenit 4 pika 3 shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë;

b) për subjektet, me objekt veprimtarie sipas nenit 4 pika 3 shkronja “d”, nga 400 000 (katërqind

mijë) lekë deri në 700 000 (shtatëqind mijë) lekë;

c) për subjektet, me objekt veprimtarie sipas nenit 4 pika 3 shkronja “dh” nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 300 000 (treqind mijë) lekë;

ç) për subjektet, me objekt veprimtarie sipas nenit 21 pika 1, nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 400 000 (katërqind mijë) lekë.

Këto shkelje shoqërohen edhe me konfiskimin e pajisjeve, që kanë shërbyer për të kryer veprimtarinë e jashtëligjshme.

2. Për punime vetëm me karakter operacional ose ndihmës të palicencuar, në funksion të veprimtarisë së autoriparimit, të përcaktuara në seksionet e regjistrit, sipas pikës 1 të nenit 3 të këtij ligji, të ndryshme nga ato për të cilat subjekti është regjistruar, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë.

3. Shkelja e dispozitave të nenit 7 të këtij ligji përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri në 40 000 (dyzet mijë) lekë.

4. Përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë shkeljet e mëposhtme:

a) mungesat ose parregullsitë në plotësimin e regjistrave të parashikuar nga ky ligj, si dhe përdorimi i regjistrave të pavulosur apo me fletë mangët;

b) kryerja e veprimeve me persona të paidentifikuar me letërnjoftim ose dokument tjetër identifikimi.

Neni 40
Shkelja e kushteve të lejes

1. Kur titullari i njërës prej lejeve të parashikuara në këtë ligj shkel kushtet e përcaktuara në të, kryen kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri 400 000 (katërqind mijë) lekë.

2. Gjoba e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni zbatohet edhe kur titullari i njërës prej lejeve të parashikuara në këtë ligj nuk zbaton dispozitat dhe udhëzimet e dala në zbatim të këtij ligji.

Neni 41
Shkelje të tjera

l. Përveçsa është parashikuar në nenet e mësipërme të këtij kreu, shkeljet e dispozitave të tjera të këtij ligji përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) lekë deri në 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë.

2. Të ardhurat nga gjobat i kalojnë në masën 40 për qind organit që ka verifikuar shkeljen, për t'i përdorur sipas mënyrës së përcaktuar me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave, Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrit të Brendshëm, për përmirësimin e shërbimit, në zbatim të këtij ligji, kurse 60 për qind i kalojnë Buxhetit të Shtetit. Kalimi i të ardhurave në buxhet bëhet sa herë që derdhen para në bankë, duke respektuar raportin e lartpërmendur.

Neni 42
Pushimi dhe pezullimi i veprimtarisë

1. Punonjësit e DPSHTRR-së dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që kryejnë kontrollin, kur vërejnë kundërvajtjet e parashikuara në nenet e mësipërme, kanë detyrimin të paraqesin një raport me shkrim dhe të vënë në dijeni, pa vonesë, autoritetin që ka lëshuar lejen.

2. Ky autoritet, me të marrë raportin, nxjerr urdhër, ku shënon edhe arsyet e këtij veprimi, për pezullimin e veprimtarisë së kryer pa lejen përkatëse. Urdhri duhet të zbatohet brenda pesë ditëve.

3. Autoriteti, që ka lëshuar lejen, kur vëren shmangien e subjektit nga kushtet e përcaktuara në ligj, urdhëron pezullimin e veprimtarisë për aq kohë sa nevojitet për t'i plotësuar këto kushte, por jo më pak se 24 orë dhe jo më shumë se tre muaj. Me skadimin e këtij afati leja revokohet.

4. Urdhri për pezullimin e veprimtarisë revokohet kur i interesuari provon se i ka plotësuar kushtet.

5. Drejtori i policisë në qark, për rrethana të veçanta, urgjente, ose kur rrezikohet siguria e personit,

urdhëron menjëherë pezullimin e veprimtarisë së paautorizuar.

Neni 43
Procedura e ankimit dhe afati kohor

1. Organi administrativ përkatës shqyrton ankimin administrativ dhe është i detyruar të marrë vendim brenda një muaji nga data e depozitimit të ankimit.

2. Nëse organi administrativ përkatës nuk ka marrë vendim brenda afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, për ankimin e bërë, pala e interesuar fiton të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, sipas paragrafit të dytë të nenit 328 të Kodit të Procedurës Civile.

3. Në qoftë se organi, që ka nxjerrë ose nuk ka nxjerrë lejen e ankimuar, vendos t'i pranojë kërkesat e ankimit, ai merr vendimin përkatës.

4. Në qoftë se organi i përmendur në pikën 3 të këtij neni nuk pranon kërkesat e ankimit, ai detyrohet ta transferojë ankimin tek organi epror, i cili vendos brenda 2 javëve.

Neni 44
Dispozita kalimtare

1. Regjistrohen në regjistër subjektet, të cilat në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në nenin 2 të këtij ligji, që kanë përvojë prej të paktën 5 vjetësh në këtë fushë dhe që plotësojnë kërkesat e tjera, të parashikuara në pikën 1 të nenit 5 të këtij ligji.

2. Subjektet, që përmenden në pikën 1 të këtij neni, brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit, duhet t'i njoftojnë, me shkrim, ministrisë që mbulon fushën e transportit, emrin e drejtuesit teknik, sipas nenit 8 të këtij ligji.

Neni 45
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4989, datë 21.7.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J
Nr.9574, datë 3.7.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8450, DATË 24.2.1999 "PËR PËRPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Kudo në ligj emërtimi "Drejtoria e Përgjithshme e Hidrokarbureve" zëvendësohet me emërtimin "Struktura përgjegjëse për veprimtarinë e hidrokarbureve.".

Neni 2

Pika 4 e nenit 14 ndryshohet si më poshtë:

"4. Shoqëria e tregtimit me shumicë përgjigjet për sasinë dhe cilësinë e ngarkesës gjatë transportit.".

Neni 3

Neni 12.1 shfuqizohet.

Neni 4

Kudo në nenin 17 hiqen fjalët "Leje përpunimi".

Neni 5

Neni 18.1 shfuqizohet.

Neni 6

Neni 21 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 21

Personat juridikë, që paraqesin kërkesë për leje tregtimi, sipas nenit 19 të këtij ligji, janë të detyruar të plotësojnë kushtin e kapacitetit të depozitimit në instalimet, prona të tyre ose të marra në përdorim me kontratë, për një periudhë kohore të barabartë me atë të vlefshmërisë së lejes së tregtimit. Kushtet e dhënies së lejes së tregtimit përcaktohen nga Këshilli i Ministrave. Kushti i kapacitetit të depozitimit specifikohet, sipas llojit të lejes dhe kategorisë së produkteve që tregtojnë.".

Neni 7

Në nenin 25 bëhen këto ndryshime:

a) Fjalët "Impiante përpunimi" dhe "Leje përpunimi" hiqen.

b) Paragrafi i fundit i pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

"Masa e gjobës, e parashikuar në shkronjat "a" dhe "b" të këtij neni, jepet nga ministri përgjegjës për veprimtarinë e hidrokarbureve, ndërsa të gjitha gjobat e tjera jepen nga Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre.".

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4990, datë 21.7.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J
Nr.9575, datë 3.7.2006

PËR FALJEN E GJOBAVE TË KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE, SI DHE TË TATIMIT MBI TË ARDHURAT NGA PUNËSIMI PËR PERSONAT JURIDIKË E FIZIKË, TË REGJISTRUAR SI TATIMPAGUES TË

TAKSËS VENDORE MBI BIZNESIN E VOGËL, PËR PERIUDHAT TATIMORE TË VITIT 2005

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Personave juridikë e fizikë, të regjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël, u falen gjobat e vendosura, që i përkasin të gjitha periudhave tatimore të vitit 2005, që lidhen me deklarimin dhe pagimin me vonesë të detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore, të kontributeve të sigurimit të kujdesit shëndetësor dhe të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, me kusht që deklarimi dhe pagesa të bëhen brenda datës 31.12.2006.

Neni 2

Personave juridikë e fizikë, të regjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël, u rimbursohet shuma e gjobave të paguara, që i përkasin të gjitha periudhave tatimore të vitit 2005, që lidhen me deklarimin dhe pagimin me vonesë të detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore, të kontributeve të sigurimit të kujdesit shëndetësor dhe të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi.

Neni 3

Çështjet në proces apelimi dhe çështjet për ekzekutimin e vendimeve të gjykatave, që kanë marrë formë të prerë, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që lidhen me gjobat e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, pushohen.

Subjektet shtetërore kreditore detyrohen që, në përputhje me shkronjën "b" të nenit 616 të Kodit të Procedurës Civile, menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të paraqesin pranë organeve të përmbarimit kërkesë për pushimin e ekzekutimit.

Neni 4

Ngarkohen për zbatimin e këtij ligji të gjitha institucionet shtetërore, të prekura nga fusha e zbatimit të tij.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4991, datë 21.7.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J
Nr.9576, datë 3.7.2006

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8461, DATË 25.2.1999 “PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pikat 2 e 3 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas nenit 10 shtohen nenet 10/1, 10/2, 10/3, 10/4 e 10/5 me këtë përmbajtje:

“Neni 10/1

Në sistemin e arsimit të lartë funksionon Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës, si organ këshillimor i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe i Këshillit të Ministrave për hartimin dhe realizimin e politikave të zhvillimit të arsimit dhe të shkencës.

Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës ka këto detyra:

a) këshillon Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet e arsimit të lartë dhe të shkencës për hartimin e strategjive e të programeve kombëtare për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor;

b) këshillon Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për drejtimet e politikës së arsimit të lartë, kërkimit shkencor dhe zhvillimit teknologjik;

c) sugjeron fushat parësore të kërkimit shkencor dhe zhvillimit teknologjik dhe programet kombëtare të kërkimit shkencor dhe zhvillimit;

ç) këshillon Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore për arsimin e lartë, shkencën dhe zhvillimin teknologjik, me synim edhe përafrimin e tyre me legjislacionin e BE-së;

d) sugjeron kriteret për vlerësimin, akreditimin dhe riakreditimin e institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë, shkencës dhe zhvillimit teknologjik;

dh) Sugjeron kriteret e dhënies së gradave dhe të titujve shkencorë;

e) këshillon Ministrin e Arsimit dhe Shkencës edhe për çështje të tjera, që Ministri i vlerëson të rëndësishme.

Sugjerimet e bëra nga Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës, për të cilat kërkohet miratimi i Këshillit të Ministrave, paraqiten për miratim nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Neni 10/2

Përbërja e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës

Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës përbëhet nga 19 veta si më poshtë:

a) Ministri i Arsimit dhe Shkencës	- Kryetar
b) Kryetari i Akademisë së Shkencave	- anëtar
c) Kryetari i Konferencës së Rektorëve	- anëtar
ç) Një përfaqësues i caktuar nga Ministri i Financave	- anëtar
d) 15 përfaqësues, ekspertë të fushës së arsimit të lartë, shkencës, teknologjisë dhe sektorit privat	- anëtarë.

Neni 10/3

Kriteret për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës

Anëtari i përcaktuar në shkronjën “d” të nenit 10/2 duhet të plotësojë këto kritere:

a) të ketë dhënë kontribut në zhvillimin e arsimit të lartë dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë;

b) të ketë, së paku, gradën “doktor shkencash”, të fituar me rezultatin “shumë mirë” ose “shkëlqyeshëm”, si dhe të ketë, së paku, një përvojë pune 5-vjeçare, pas mbrojtjes së doktoratës, si pedagog apo bashkëpunëtor shkencor i brendshëm në shkollën e lartë ose në një qendër kërkimore;

c) të ketë qenë, së paku, pesë vjet pedagog ose bashkëpunëtor shkencor i brendshëm në shkollën e lartë ose në një qendër kërkimore gjatë 10 viteve të fundit;

ç) të ketë përvojë akademike ose kërkimore në qendra mësimore-kërkimore ndërkombëtare të njohura, pas marrjes së gradës “doktor shkencash”;

d) të ketë botuar shkrime origjinale në 10 vitet e fundit në revista shkencore të huaja, të njohura në

indeksin shkencor ndërkombëtar (me impact-factor) dhe të ketë referuar në konferenca të rëndësishme shkencore europiane e më gjerë;

dh) të ketë kontribuar në përgatitjen e shkencëtarëve të rinj dhe të ketë udhëhequr të paktën një doktoratë;

e) të ketë treguar aftësi në konceptimin, hartimin dhe përgatitjen e strategjive në fushën përkatëse;

ë) të ketë treguar aftësi në planifikimin dhe drejtimin e punës kërkimoreshkencore në nivel ekspertësh.

Kriteri i përcaktuar në shkronjën "c" të paragrafit të mësipërm nuk zbatohet për kandidatët, që kanë përfunduar studime të plota doktorate në shkollat e larta të huaja të njohura, me rezultatin "shumë mirë" ose "shkëlqyeshëm".

Ministri i Financave cakton si përfaqësues në Këshillin e Arsimit të Lartë dhe Shkencës njërin ndër punonjësit e kësaj ministrie, i cili ka kualifikimin profesional dhe përvojën e duhur, të njëjtë me përfaqësuesit ekspertë.

Neni 10/4

Mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve të tjerë të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës

Anëtarët e përcaktuar në shkronjën "d" të nenit 10/2 përzgjidhen nga fusha të ndryshme të shkencës, me konkurrim publik, nga një komision përzgjedhjeje, i ngritur në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, i përbërë me një përfaqësues nga Kuvendi, një përfaqësues nga Këshilli i Ministrave, një përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe një përfaqësues nga Konferenca e Rektorëve, të caktuar nga vetë këto institucione.

Komisioni i përzgjedhjes, pasi shqyrton plotësimin e kritereve profesionale, në përputhje me këtë ligj, rendit në një listë kandidatët, sipas pikëve të fituara.

Këshilli i Ministrave emëron në detyrën e anëtarit të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës 15 kandidatë, nga lista e paraqitur nga komisioni përzgjedhës.

Anëtarët e përcaktuar në shkronjën "d" të nenit 10/2 zgjidhen për një mandat 7-vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje. Në Këshillin e parë të Arsimit të Lartë dhe Shkencës (KALSH) pesë anëtarë të tij do të kenë mandat 3-vjeçar dhe pesë anëtarë të tjerë do të kenë një mandat 5-vjeçar. Përcaktimi i tyre do të bëhet me short. Në vijim mandati i anëtarëve të këtij Këshilli do të jetë 7-vjeçar.

Neni 10/5

Funksionimi i Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës

Veprimtaria e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës ushtrohet në përputhje me rregulloren, që miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Në përputhje me rregulloren, Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës mund të ngrejë edhe komisione e grupe pune të përkohshme ekspertësh, vendas apo të huaj, sipas fushave.

Për realizimin e detyrave, Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës mbështetet nga një sekretariat teknik, i ngritur në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, i cili është i përbërë nga punonjës të kësaj Ministrie.

Masa e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 2

Në nenin 13, pas paragrafit të tretë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Ministria e Arsimit dhe Shkencës miraton formën dhe përmbajtjen e diplomës dhe të shtojcës së diplomës, që lëshohen nga shkollat e larta.".

Neni 3

Në nenin 19, në paragrafin e dytë, togfjalëshi "çdo tre vjet" zëvendësohet me togfjalëshin "çdo 4 vjet".

Neni 4

Në nenin 31 bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Pranimet në shkollat e larta publike bëhen në bazë të kuotave. Kuotat e pranimit për sistemin e studimeve me kohë të plotë propozohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave. Kuotat për sistemin e studimeve me kohë të pjesshme, në distancë, si dhe i formave të tjera të studimit përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Për këto kuota zbatohen tarifa të veçanta shkollimi, të cilat caktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrit të Financave.

Për përcaktimin e kuotave dhe të tarifave të shkollimit merret edhe mendimi i shkollave të larta.”.

b) Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Kuotat e pranimit për shkollat e larta ushtarake ose të policisë propozohen nga ministritë përkatëse dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.”.

c) Paragrafi i tretë shfuqizohet.

ç) Paragrafi i katërt dhe i pestë ndryshohen si më poshtë;

“Pranimet në shkollën e lartë publike bëhen me konkurrim. Mënyra e konkurrimit përcaktohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Kur numri i kandidatëve të regjistruar është më i vogël se kuota e parashikuar, pranimet janë të hapura.

Pranimi i studentëve në shkollat e larta bëhet në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, sipas kuotave të miratuara.”.

Neni 5

Në nenin 35, paragrafi i parë dhe i dytë ndryshohen si më poshtë:

“Sistemi i studimeve në shkollat e larta është me kohë të plotë, me kohë të pjesshme, në distancë, si dhe në çdo formë tjetër ndërthurrjeje të këtyre formave. Mënyra dhe kriteret përcaktohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës me akte nënligjore.

Studimet në shkollat e larta kryhen në vite akademike. Në shkollat e larta universitare studimet janë të organizuara në cikle studimi. Cikli i parë i studimeve zgjat, të paktën, 3 vite akademike, me një ngarkesë mësimore prej jo më pak se 60 kredite ECTS (Sistemi Europian i Transferimit të Krediteve) në vit. Në përfundim të ciklit të parë të studimeve studentët marrin diplomë “Bachelor” dhe shtojcën e diplomës. Cikli i dytë i studimeve, që është vazhdim i ciklit të parë, zgjat 1-2 vite akademike, me një ngarkesë mësimore prej jo më pak se 60 kredite ECTS në vit. Në përfundim të ciklit të dytë të studimeve, studentët marrin diplomë “Master”. Diploma shoqërohet me listën e notave, e cila pasqyron kualifikimin e studentit, sipas vlerësimit kombëtar dhe atij në kredite. Organizimi i ciklit të dytë të studimeve “Master” bëhet me të njëjtat procedura, si ato të përcaktuara në paragrafin e shtatë dhe të tetë të nenit 13 të ligjit.

Në shkollat e larta jouniversitare studimet zgjasin 2 vite akademike. Studenti, në përfundim të tyre, merr diplomën përkatëse.”.

Neni 6

Në nenin 38, paragrafi i parë dhe i dytë ndryshohen si më poshtë:

“Kualifikimi shkencor pasuniversitar realizon përgatitjen e specialistëve, të aftë për të kryer veprimtari kërkimore-shkencore. Kualifikimi shkencor pasuniversitar kryhet pranë shkollave të larta universitare dhe përfundon me dhënien e gradës shkencore “doktor i shkencave”.

Hapja dhe mbyllja e shkollës pasuniversitare bëhet me të njëjtat procedura, të përcaktuara në paragrafin e shtatë dhe të tetë të nenit 13 të ligjit.”.

Neni 7

Pas nenit 44 shtohet neni 44/l me këtë përmbajtje:

“Neni 44/1

Zgjedhjet e para për afatin e ri katërvjeçar për autoritetet dhe organet drejtuese në shkollat e larta shpallen menjëherë me fillimin e vitit të ri akademik, në vitin kur mbaron afati trevjeçar i zgjedhjeve të fundit.

Autoritetet dhe organet drejtuese, të zgjedhura për mandatin 3-vjeçar, vazhdojnë detyrën deri në zgjedhjen e autoriteteve dhe të organeve të reja drejtuese në shkollat e larta.

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të përgatisë dhe të paraqesë për miratim në Kuvend projektligjin, ku të përcaktohen edhe mënyrat dhe procedurat për zhvillimin e zgjedhjeve, të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni."

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4992, datë 21.7.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.48, datë 13.7.2006

PËR ZËVENDËSIMIN E DY ANËTARËVE NË KËSHILLIN E LARTË TË DREJTËSISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 147 pika 1 të Kushtetutës, të nenit 4 pika 2 të ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", të ndryshuar, në zbatim të vendimit nr.14, datë 22.5.2006 të Gjykatës Kushtetuese dhe të nenit 111 pika 1 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Për të përfaqësuar Kuvendin

I. Zoti Ardian Nuni zgjidhet anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe zëvendëson zotin Sokol Çomo.

Për të përfaqësuar Kuvendin

II. Zoti Guxim Zenelaj zgjidhet anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe zëvendëson zonjën Pranvera Strakosha.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.49, datë 13.7.2006

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË GRUPIT MBIKËQYRËS TË KONTROLLIT FINANCIAR TË PERSONAVE JURIDIKË JOBANKARË QË KANË MARRË HUA NGA PUBLIKU I GJERË

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 2 të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Nail Kastrati lirohet nga detyra e anëtarit të grupit mbikëqyrës të kontrollit financiar të

personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë.

II. Zoti Pal Metaj caktohet anëtar i grupit mbikëqyrës të kontrollit financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë në vend të zotit Nail Kastrati.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.50, datë 13.7.2006

PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË KOMISIONIT TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 21 të ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Koço Broka emërohet anëtar i Komisionit të Konkurrencës.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.52, datë 17.7.2006

PËR EMËRIMIN E KRYETARIT TË KOMISIONIT TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 21 pika 1 të ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Lindita Lati emërohet Kryetare e Komisionit të Konkurrencës.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKRET
Nr.4982, datë 19.7.2006

PËR LIRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92 pika dh të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Viktor Kalemi lirohet nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën Arabe të Egjiptit, rezident, si dhe e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Indisë dhe në Republikën Arabe të Sirisë, jorezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.4983, datë 19.7.2006

PËR EMËRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92, pika dh, dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Anila Bitri, Ambasadore e Jashtëzakonshme dhe Fuqiplotë e Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Spanjës, rezidente, emërohet Ambasadore e Jashtëzakonshme dhe Fuqiplotë e Republikës së Shqipërisë në Marok dhe Mauritani, jorezidente.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.486, datë 14.7.2006

PËR CAKTIMIN E DATËS SË KRIJIMIT TË SHËRBIMIT SEKRET TË SHTETIT SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e datës 17 dhjetor 1912 si datën e krijimit të Shërbimit Sekret të Shtetit Shqiptar.
2. Ngarkohet Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.488, datë 14.7.2006

PËR VEPRIMTARINË FINANCIARE TË QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 16 të ligjit nr.8502, datë 30.6.1999 "Për krijimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpenzimet për botimet e Qendrës së Publikimeve Zyrtare përfshijnë koston e prodhimit dhe koston e shpërndarjes nga ana e postës.
2. Qendra e Publikimeve Zyrtare realizon edhe shpërndarjen e normave juridike, në mënyrë elektronike, me internet dhe CD-ROM.
3. Tarifat e përdorimit të shërbimeve të përparuara në internet dhe të produkteve dixhitale caktohen me urdhër të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Financave.
4. Qendra e Publikimeve Zyrtare përdor shërbimin bazë të "Posta Shqiptare" sh.a. për shpërndarjen e Fletores Zyrtare.
5. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.507, datë 19.7.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.590, DATË 22.12.1997 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE NË KËSHILLIN ADMINISTRATIV TË INSTITUTIT TË SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 20 të ligjit nr.7870, datë 13.4.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Paragrafi i dytë i vendimit nr.590, datë 22.12.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Z.Arben Ivanaj, me detyrë zëvendësministër i Shëndetësisë, si përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.509, datë 19.7.2006

PËR PËRBËRJEN E KËSHILLIT DREJTUES TË AGJENCISË SHQIPTARE TË BIZNESIT DHE

INVESTIMEVE DHE PËR MËNYRËN E MASËN E SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË TIJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr.9497, datë 20.3.2006 "Për krijimin e Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshilli drejtues i Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve kryesohet nga Ministri i Ekonomisë dhe Energjetikës dhe ka në përbërje:

- Zëvendësministrin e Financave;
- Zëvendësministrin e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit;
- Zëvendësministrin e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;
- Një përfaqësues nga Këshilli i Ministrave;
- Tre përfaqësues nga organizatat e biznesit.

2. Përfaqësuesit e organizatave të biznesit miratohen nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, sipas kritereve të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

3. Shpërblimi i anëtarëve të këshillit drejtues të Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve bëhet në bazë të pjesëmarrjes në mbledhje dhe përballohet nga buxheti i kësaj Agjencie.

Masa e shpërblimit të tyre është 5 000 (pesë mijë) lekë për çdo mbledhje.

4.Vendimi nr.344, datë 11.7.2002 i Këshillit të Ministrave "Për përbërjen e këshillit mbikëqyrës të Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja e për mënyrën dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të tij", shfuqizohet.

5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.39, datë 14.7.2006

PËR MOSFILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të nenit 9, nenit 13, pika 1 germa d, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të nenit 9 të vendimit nr.37, datë 9.7.2004 "Rregullore për procedurat e licencimit", si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 "Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", me ndryshimet përkatëse, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.7.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Wonder Power" sh.a. për licencim në aktivitetin e eksportit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Mosfillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës për licencimin e shoqërisë "Wonder Power" sh.a., për aktivitetin e eksportit të energjisë elektrike.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.40, datë 14.7.2006

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR PERIUDHËN 1.1.2005 DERI MË 31.12.2005, PËR SHOQËRINE "JUANA" SHPK

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa b, 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", me ndryshimet e ligjit nr.9512, datë 10.4.2006 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe vendimit nr.60, datë 29.12.2004 të Bordit të Komisionerëve "Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël", Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 14.7.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga "Juana" sh.p.k., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për periudhën 1.1 2005 – 31.12. 2005,

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga "Juana" sh.p.k., për periudhën nga 1.1.2005 deri më 31.12. 2005 të jetë 5.35 lekë/kWh.
2. Ngarkohet "Juana" sh.p.k. dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.41, datë 14.7.2006

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR PERIUDHËN 1.10.2005 DERI MË 31.12.2006 PËR SHOQËRINË "MARJAKAJ" SHPK

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa b, 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", me ndryshimet e ligjit nr.9512, datë 10.4.2006 "Për disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike " dhe vendimit nr.60, datë 29.12.2004 të Bordit të Komisionerëve "Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël", Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 14.7.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga "Marjakaj" sh.p.k., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për periudhen 1.10. 2005 – 31.12.2006,

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga "Marjakaj" sh.p.k., për periudhën nga 1.10.2005 deri më 31.12. 2006, të jetë 4.2 lekë/kWh.
2. Ngarkohet "Marjakaj" sh.p.k. dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.42, datë 14.7.2006

PËR MOSFILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT PËR APLIKIMIN PËR NDËRTIMIN DHE INSTALIMIN E NJË H/C TË RI NGA SHOQËRIA REMI SHPK

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1 germa a, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", ndryshuar me ligjin nr.9512, datë 10.4.2006 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin

nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", neni 7, të ligjit nr.7973, datë 25.7.1995 "Për koncensionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë" me ndryshimet përkatëse, si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 "Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s," me ndryshimet përkatëse, neni 11; vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 14.10.2004 "Për miratimin e rregullores për procedurat e licencimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve elektrike me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW dhe prodhimin e energjisë elektrike nga këto centrale", neni 9, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.7.2006, pasi shqyrtoi aplikimin për ndërtimin dhe instalimin e një H/C të ri nga shoqëria REMI sh.p.k., konstatoi se shoqëria Remi sh.p.k.:

- nuk ka paraqitur vendim të Këshillit të Ministrave për miratim të marrëveshjes së koncensionit të formës BOO si propozim i pakërkuar,
- nuk ka paraqitur në ERE leje të ndërtimit nga organet kompetente përkatëse të pushtetit vendor.

Në analizë të sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Mosfillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për ndërtimin dhe instalimin e një H/C të ri nga shoqëria REMI sh.p.k., pasi kjo kompani nuk ka përfunduar procedurat e marrjes në koncension dhe marrjes së lejes së ndërtimit nga organet kompetente të pushtetit vendor.
2. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Departamenti i Licencave dhe Monitorimit të njoftojnë shoqërinë Remi sh.p.k. mbi vendimin e Bordit të Komisionerëve dhe mangësitë në dokumentacionin e dërguar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.43, datë 14.7.2006

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të neneve 9 dhe nenit 26, pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.109, datë 22.2.2006 "Për normën e lejuar të faktorit të fuqisë", si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.05.2004 "Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.25, datë 27.05.2005, neni 11, germa A, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.07.2006, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria KESH sh.a. për përcaktimin e çmimeve të energjisë reaktive për subjektet jofamiliare,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, për përcaktimin e çmimeve të energjisë reaktive për subjektet jofamiliare të kërkuar nga shoqëria KESH sh.a.

2. Ngarkohet Departamenti i Çmimeve dhe Tarifave, si dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun, Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për shqyrtimin e aplikimit të paraqitur nga shoqëria KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.44, datë 21.7.2006

PËR MOSPRANIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË GSA SHPK PËR AKTIVITETIN E EKSPORTIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje te neneve 9, 13 pika 1 germa d; 15, pika 2, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", me ndryshimet përkatëse, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.27, datë 30.5.2004 "Rregullorja për procedurat e licencimit", neni 12 pika 2, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.7.2006, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria Grupi i Sistemeve Automatike (GSA sh.p.k.) për marrje të licencës për aktivitetin e eksportit të energjisë elektrike, konstatoi se nga të gjitha kërkesat e parashikuara në aktet e mësipërme, GSA sh.p.k. nuk i ka plotësuar tërësisht ato, si dhe nuk ka dërguar informacionin shtesë të kërkuar nga ERE.

Për sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Mospranimin e aplikimit të shoqërisë GSA sh.p.k. për licensë për aktivitetin e eksportit të energjisë elektrike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.483, datë 17.7.2006

MBI LICENCËN E SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR "TV PËRMETI"

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Halil Lalaj	Kryetar
Sefedin Çela	anëtar
Albert Minga	anëtar
Visar Zhiti	anëtar
Agim Duro	anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga z. Gjergji Petro për ndryshimin e të dhënave që kanë ndodhur në kërkesën për marrjen e licencës së "TV Përmeti".

BAZA LIGJORE: Neni 7, pika 21, neni 22 dhe neni 30 i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë",

VËREN:

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, me vendimin nr.427, datë 21.3.2006, ka licencuar subjektin fizik z.Gjergji Petro për televizionin "TV Përmeti" me numër licence 078/TVL, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve televizive analogjike tokësore, për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence. Licenca ka hyrë në fuqi në datën 10.4.2006.

Në datën 11.7.2006 (nr.596 prot.) është paraqitur nga ana e z.Gjergji Petro kërkesa për ndryshimin e të dhënave që kanë ndodhur në kërkesën për marrjen e licencës, lidhur me ndryshimin e formës ligjore të subjektit. Nga ana e këtij personi, është krijuar me vendimin nr.36135, datë 11.7.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë shoqëria "TV Përmeti" sh.p.k. me ortak të vetëm dhe administrator z.Gjergji Petro.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është veprimtari radiotelevizive, që përfshin prodhimin,

transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji, me anë të zërit dhe figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit të destinuar për publikun, nëpërmjet valëve elektromagnetike, kabllove, përsëritësve, satelitëve dhe çdo mjeti tjetër.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit, pasi shqyrtoi kërkesën e z.Gjergji Petro, e vlerëson këtë kërkesë të mbështetur në nenin 30 (Detyrimi për njoftimin e ndryshimeve) të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë".

KKRT vëren se, në mbështetje të nenit 22 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë": "Licenca e transmetimit është e patjetërsueshme dhe vlen vetëm për subjektin të cilit i është dhënë. Në rast se mbajtësi i licencës hyn në marrëdhënie juridike civile, objekt i të cilave është edhe veprimtaria radiotelevizive e licencuar, atëherë për cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca kërkohet miratimi i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit. Subjektit që ka fituar këto të drejta, miratimi i jepet në formën e një licence të re me të njëjtën përmbajtje".

Duke e vlerësuar kërkesën nga kjo pikëpamje, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit konstaton se kërkesa e z. Gjergji Petro i nënshtrohet tjetërsimit të licencës.

PËR KËTO ARSYE,

Në mbështetje të nenit 7, pika 21, nenit 22, nenit 30 dhe 33, pika 3, të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T'i heqë subjektit fizik, z.Gjergji Petro, licencën për TV vendor "Përmeti".
2. Licenca nr.078/TVL bëhet e pavlefshme.
3. T'i japë subjektit juridik, shoqërisë "TV Përmeti" sh.p.k., me vendndodhje në qytetin e Përmetit, licencë me të njëjtën përmbajtje, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve televizive analogjike tokësore për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
4. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
5. Ngarkohet administrata e KKRT-së për kryerjen e veprimeve të mëtejshme në zbatim të këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.484, datë 17.7.2006

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVIZIONIN VENDOR PRIVAT "DURRËSI"
SUBJEKTIT JURIDIK: SHOQËRIA "TV DURRËSI" SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", rregullores "Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim RTV analogjik tokësor në nivel vendor", të miratuar me vendimin nr.355, pika 1, datë 29.8.2005 të KKRT-së, të vendimit nr.474, datë 29.06.2006 të KKRT-së "Mbi licencën e subjektit televiziv vendor privat TV Durrësi", si dhe rregullores "Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", të miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005 të KKRT-së, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T'i japë subjektit juridik, shoqërisë "TV Durrësi" sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve televizive analogjike tokësore, për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetet Tiranë dhe Durrës.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.485, datë 17.7.2006

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVIZIONIN KABLLOR PRIVAT "MIRDITA"
SUBJEKTIT: SHOQËRIA "REÇI KGM" SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", rregullores "Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.375, datë 30.11.2005, rregullores "Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll", të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.03.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T'i japë shoqërisë "Reçi KGM" sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të licencës, për të penetruar në qytetin e Rrëshenit.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e saj, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Halil Lalaj

VENDIM
Nr.486, datë 17.7.2006

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVIZIONIN KABLLOR PRIVAT "ERZENI"
SUBJEKTIT FIZIK: SHKËLQIM BËRHAMI

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", rregullores "Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.375, datë 30.11.2005, rregullores "Për licencimin e operatorëve radiotelevizive të transmetimeve me kabëll", të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.03.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T'i japë subjektit fizik, z. Shkëlqim Bërhami, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të licencës, për të penetruar në qytetin e Shijakut.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e saj, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.487, datë 17.7.2006

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVIZIONIN KABLLOR PRIVAT "SYNEJ"
SUBJEKTIT FIZIK: GRAMOZ ISMAILI

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", rregullores "Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.375, datë 30.11.2005, rregullores "Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll", të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.03.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T'i japë subjektit fizik, z.Gramoz Ismaili, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të licencës, për të penetruar në komunën Synej-Kavajë.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e saj, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.488, datë 17.7.2006

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR "TOP CHANNEL"

Në mbështetje të nenit 7, pika 21, dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të "Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr.162 të KKRT-së, të vendimit nr.478, datë 29.6.2006 të KKRT-së, nenit 112 pika 2/a të Kodit të Procedurave Administrative të RSH, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.049/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin "Top Channel" sh.a. për televizionin "Top Channel".
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 19.6.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.489, datë 17.7.2006

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR "TELE-SPORT"

Në mbështetje të nenit 7, pika 21, dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të "Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr.162 të KKRT-së, të vendimit nr.478, datë 29.6.2006 të KKRT-së, nenit 112 pika 2/a të Kodit të Procedurave Administrative të RSH, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.047/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin "Tele Sport l" sh.p.k. për televizionin "Tele-Sport".
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 7.5.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.490, datë 17.7.2006

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR "TV KOHA"

Në mbështetje të nenit 7, pika 21, dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të "Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr.162 të KKRT-së, të vendimit nr.478, datë 29.6.2006 të KKRT-së, të nenit 112 pika 2/a të Kodit të Procedurave Administrative të RSH, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr. 035/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin "Media 99" sh.a. për televizionin "TV Koha".
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 3.1.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.491, datë 17.7.2006

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR "TV VIZION +"

Në mbështetje të nenit 7, pika 21, dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të "Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr.162 të KKRT-së, të vendimit nr.478, datë 29.06.2006 të KKRT-së, të nenit 112 pika 2/a të Kodit të Procedurave Administrative të RSH, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr. 038/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, shoqërinë "Media Vizion" sh.a. për televizionin vendor privat "TV Vizion +".
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 3.1.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.492, datë 17.7.2006

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK VENDOR "HOUSE OF ARTS"

Në mbështetje të nenit 7, pika 21, dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të "Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr.162 të KKRT-së, të nenit 113 pika c të Kodit të Procedurave Administrative të RSH, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr. 050/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë shoqërinë "House of Arts Radio Televizion" sh.p.k. për radion "House of Arts".
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 23.9.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.493, datë 17.7.2006

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK VENDOR "EURO STAR MUSIC"

Në mbështetje të nenit 7, pika 21, dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të "Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr.162 të KKRT-së, të nenit 113 pika c të Kodit të Procedurave Administrative të RSH, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr. 048/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë shoqërinë "Radio Eurostar Music" sh.p.k. për radion "Euro Star Music".
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 23.9.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.494, datë 17.7.2006

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK VENDOR "RADIO +3"

Në mbështetje të nenit 7, pika 21, dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të "Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr.162 të KKRT-së, të nenit 113 pika c të Kodit të Procedurave Administrative të RSH, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr. 045/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë shoqërinë "Radio +3" sh.p.k. për "Radio +3".
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 23.09.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.495, datë 17.7.2006

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK ME PËRSËRITËS "RADIO BBC"

Në mbështetje të nenit 7, pika 21, dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të "Rregullores për licencimin e operatorëve për ritransmetimin e programeve të huaja televizive dhe radio me përsëritës", të "Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr.162 të KKRT-së, të nenit 113 pika c të Kodit të Procedurave Administrative të RSH, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.003/PPH, të rinovojë për një afat të ri 4-vjeçar për ritransmetimin e programeve të huaja, radion me përsëritës "BBC".
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 11.9.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të objektit “Për ndërtimin e projektit ujësjellës-kanalizime Fushë-Krujë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është bashkia Fushë-Krujë. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për secilin person sipas listës emërore të mëposhtme.

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRITMI I PROJEKTIT UJËSJELLËS-KANALIZIME FUSHË-KRUJË

Nr.	Emri	Pasuria	Zona kadastrale	Sipërfaqja	Çmimi në lekë për m^2	Vlera në lekë
1.	Pashk Steli Filke Steli Petrit Steli Marjana Steli Gjok Steli	45/9	1934	450 m^2	1466.3	659.835
2.	Bib Musteqja	53/5	1934	452 m^2	1466.3	662.767
3.	Lek Musteqja	52/19	1934	451	1466.3	661.301

Vlera totale e këtij shpronësimi është 1 983 903 (një milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e tre) lekë.

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare
ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark",
prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. **KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
2. **KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
3. **REGJISTRAT E NOTERISË**
4. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1.	**PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006)……**	**1500**
2.	**PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) …….**	**600**
3.	**PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)**	**1500**
4.	**PËR TAKSAT DHE TATIMET…(+ suplement 2006)……**	**1500**

1.	**TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT……**	**1500**
2.	**TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT……**	**2000**

Botime të reja

1.	**PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT……**	**500**
2.	**KODI DOGANOR……...**	**1000**
3.	**KODI DETAR ……**	**1000**

Hyri në shtyp më 26.7.2006
Doli nga shtypi më 28.7.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Ilar"
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë